

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – Departamenti për krime të rënda - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi , kryetari i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Have Haliti anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Eroll Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.35/18 të datës 12.09.2018 , në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.nentor.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet, si e pabazuar ankesa e të akuzuarit S.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.35/18 të datës 12.09.2018, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin PKR.nr.35/18 të datës 12.09.2018, të akuzuarin S.M., e ka shpallur fajtor për veprën penale marrja Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600(gjashtëqind)€, e të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, duke ia llogaritur 20€ për një ditë burgim.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50€, e të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga i akuzuari është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuan në peshë prej 0.53gr, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari S.M., lidhur me vendimin mbi dënimin me gjobë me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim me gjobë më të ulët e më të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.491/18, datë 23.10.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar , ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar:

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin aktgjykim sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se i njëjti aktgjykim nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar gjendja faktike ngase i akuzuari e ka pranuar fajësinë siç parashihet me dispozitat e 248 te KPRK-së, e i cili pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden ne shkresat e lendes dhe është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti pranim ka mbështetje në faktet që i përmban aktakuza.

Ndërsa sipas pretendimit ankimor të akuzuarit që ka të bëjë me vendimin lidhur me sanksionin penal – *neni 383 par.1 nën par 1.4 të KPPK-së*, kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marr për bazë të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat i akuzuari i cek në ankesë e të cilat ndikojnë në zgjidhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin S.M., ka marrë, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sasinë e vogël të narkotikut më pakë se 1gr ,andaj, edhe Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar me gjobë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i këtij dënimi nga neni 41 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr. 517/18 dt. 09.11.2018

Procesmbajtesi

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit

Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi

Have Haliti
